



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

Konform nenit 35.2, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, autorizimit ZKA dhe procedurës së prokurimit nr. 613 -19- 9477 -5-2-5, drejtorja e prokurimit Lipjan lidhë;

ANEKS KONTRATES

E lidhur në Lipjan më 17/12/2019 në mes të:

I – Komunës së Lipjanit, autoritet kontraktues të cilën e përfaqëson drejtori i prokurimit z. Adem Duriqi (në njërën anë) në tekstin e mëtejme Autoritet kontraktues dhe

II- NNP “Wenda” nga Vushtrria të cilin e përfaqëson Kadri Selmani (ne vazhdim “Kontraktuesi”), janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

Duke pasur parasysh se palët e lartë përmendura kanë lidhur kontratën **Ndërtimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjetit të kanalizimit** Numri i identifikimit 613 019 072 521 sipas paramasës të kontratës në vlerë prej : **168,479.41€ dhe çmimin e punëve me fjalë: njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë /euro/ e katërdhjetë e një /centë/**

1.2 Gjatë ekzekutimit të punëve është parapa e nevojshme punë dhe material shtesë për përfundimin projektit “**Ndërtimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjetit të kanalizimit**). Andaj për këtë janë parapa mjete shtesë, demolimi i urave ekzistuese dhe largimi i mbetjeve deri në deponi dhe punëve të tjera të përshkruara në tabelën e poshtë shënuar.

Pjesa II. PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Ndërtimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjetit të kanalizimit					
Të gjitha pozicionet përfshijnë, demolimin dhe barjen e mbeturinave ng, transportin, shkarkimin si dhe vuarjen në vepër të materialeve për secilin pozicion					
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€)	Shuma (€)
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit të punës si dhe gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit të punës	paushall	1.00	100.00	100.00
	Demolimi i urave me eskavator me çekiç	copë	8.00	1300.00	10400

	Prerja e armaturës së urave me sharr	copë	8.00	250.00	1000.00
	Transporti i betonit dhe armaturës në deponi	copë	8.00	300.00	2400.00
1.2	Shuma e përgjithshme e aneks kontratës				14900.00

Çështja e aneks kontratës është e parapare në kontratën bazë me nr. **613-019-072-521** të kushteve të veçanta me të cilën parashihet se palët kontraktuese mund të lidhin aneks kontrate për punët shtesë të cilat nuk janë parapa në kontratë

Për këto punë shtesë kontraktuesi ka ofruar ofertën për kryerjen e punëve shtesë në bazë të çmimit për njësi të kryerjes së punëve sikurse në tenderin e hapur dhe në bazë kontratës së lidhur më 13/12/2019 me nr. ref. **613-09-9477-5-2-5**, vlera e përgjithshme punëve shtesë është **14900.00€** dhe vlera e përgjithshme e punës shtesë nuk e kalon 9% të vlerës së kontratës bazë

Në bazë të ofertës së kontraktuesit, dhe në bazë të autorizimit të Zyrës së prokurimit të marruar nga ZKA më 10/12/2019, lidhet kjo aneks kontrate.

ME KËTË PALËT KONTRAKTUESE U PAJTUAN SIQ VIJON:

1. Kontrata bazë është vazhduar edhe për punët shtese .
2. Çmimi i punëve shtese qe duhen te kryhen është 14900.00 €, me fjalë (katërmëdhjetmije e nëntëqind /euro/ zero / centë)

Te bashkëngjiten si pjese e kësaj kontrate: Kontrata bazë Ndërtimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe kyqjet e rrjetit të kanalizimit. me nr prokurimit 613 019 072-521 lidhur më **25/07/2019**

3. **Te gjitha kushtet tjera te kontratës baze mbesin te njëjta.** Njëherit shtyhet afati i përfundimit të punëve sipas pozicioneve të parapara në kontratë

SI DËSHMI E KËSAJ PALËT KONTRAKTUESE KANË NËNSHKRUAR SI MË POSHTË

PËR DHE NË EMER TË Autoritetit Kontraktues

Adem Duriqi,

Nënshkrimi

datë

PËR DHE NË EMER TË Kontraktuesit

Kadri Selmani,

Nënshkrimi

datë

